

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-103/13

**Prishtinë,
12 shkurt 2014**

Në çështjen juridike të:

D. K.

Fushë Kosovë

Paraqitësi i kërkesës /Pala përgjegjëse në ankesë

kundër

E. G.

Pala përgjegjëse në kërkesë/Pala ankuese

Kolegji i Apelit të AKP-së të Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga gjyqtarës ElkaFilcheva-Ermenkova, Kryetare e Kolegjit, EsmaErterzi dhe Sylejman Nuredini, Anëtarë, duke vendosur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/173/2012 (lënda është regjistruar në AKP me numër KPA01289), të datës 24 tetor 2012, pas shqyrtimit të mbajtur më 12 shkurt 2014, mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e E. G.e paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/C/173/2012, (lënda është regjistruar në AKP me numrin KPA 01289), i datës 24 tetor 2012
2. Konfirmohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/173/2012, për sa i përket lëndës së regjistruar në AKP me numrin KPA01289), i datës 24 tetor 2012.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Me 29 nëntor 2007, paraqitësi i kërkesës D. K. ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) duke deklaruar se E. G. e ka uzurpuar banesën që ndodhet në Rrugën “ Blok i Pestë Banesor”, Hyrja III në Glllogoc, e cila i ka takuar atij dhe se ka kërkuar ri-posedimin e saj. Kërkesa është regjistruar në AKP me numrin KPA 01289. Së bashku me kërkesën, ai paraqiti, *inter alia*, kopjen e kontratës për shitblerje, të datës 7 dhjetor 1995, e nënshkruar në mes të atij dhe Ndërmarrjes Publike Banesore në Glllogoc.
2. Më datë 31 mars 2008, KPA-ja e njoftoi E.G. lidhur me kërkesën. Ai ka pretenduar se pronën e ka blerë nga bartësi i së drejtës pronësore me çmimin në shumën prej 25.009 DM. Ai me tej ka pohuar se banesën në fjalë e ka marr në posedim me 29 janar 1996. Ai ka paraqitur një kopje të kontratës për shitblerje ku nuk figuron nënshkrimi i tij por me sa duket është e nënshkruar nga paraqitësi i kërkesës D. K. Ai ka paraqitur edhe disa faktura në emër të paraqitësit të kërkesës.
3. KPA se paraqitësi i kërkesës ashtu edhe pala përgjegjëse në kërkesë kanë paraqitur kërkesa në Drejtorinë për Çështje Pronësore Banesore për pronësi dhe posedim të së njëjtës banesë. Kjo Drejtori *ex officio*, vendosi duke i refuzuar kërkesën B të E.G. nr.DS310148 dhe kërkesën e kategorisë C të Dragan Košanin-it e regjistruar si kërkesa nr. DS308817, janë refuzuar nga KKPB-ja me vendimin nr. HPCC/D/203/2005/B&C, e datës 18 qershor 2005. Po kështu edhe kërkesa për rishqyrtim është refuzuar.
4. Drejtorinë për Çështje Pronësore Banesore në vitin 2006, ka kërkuar nga një laborator kriminologjik në Bullgari të bëjë ekzaminimin forenzik të nënshkrimit në kontratën e shitblerjes të paraqitur nga pala përgjegjëse në kërkesë E. G., që supozohet të jetë lidhur në mes tij dhe paraqitësit të kërkesës. Ekzaminimi ka vërtetuar se nënshkrimi në dokument nuk është vendosur nga D. K. Duke marrë parasysh se rezultatet e ekzaminimit forenzik nuk janë konsideruar nga KKPB-ja, Sekretariati Ekzekutiv i KKPB-së ia ka siguruar një kopje të saj palës përgjegjëse në kërkesë me 17 maj 2012, i cili nuk ka paraqitur përgjigje ndaj saj.

5. Në seancën e mbajtur nga KKPK-ja, paraqitësi i kërkesës ka përmendur se kontratën për shitblerje VR.Nr. 223/95 e datës 7 dhjetor 1995 të arritur në mes tij dhe Kompanisë Banesore Publike nuk e kishte në dispozicion, për këtë arsye edhe nuk ka mundur ta dorëzojë në KKPK bashkë me kërkesën e tij të mëparshme. Ai ka përsëritur argumentet e tij se ai nuk ia kishte shitur pronën palës përgjegjëse në kërkesë. Ai pretendoi se kontrata për shitblerje e paraqitur nga pala përgjegjëse në kërkesë është e rrejshme. Pala përgjegjëse në kërkesë ende pohon se pronën e ka blerë nga paraqitësi i kërkesës. Ai ka thënë se dëshmitari i vetëm në dijeni për këtë kontratë është vrarë gjatë konfliktit.

6. Duke marrë parasysh se kontrata për shitblerje është verifikuar pozitivisht nga AKP-ja, KKPK-ja vendosi ta miratoi kërkesën e paraqitësit të kërkesës i cili tani mund ta vërtetojë titullin e pronësisë së tij për banesën në fjalë. KKPK-ja gjithashtu vërtetoi se kontrata për shitblerje e paraqitur nga pala përgjegjëse në kërkesë nuk është e vërtetuar dhe se ekzaminimi i bërë nga eksperti i forenzikës në Bullgari, gjeti se nënshkrimi i paraqitësit të kërkesës në kontratën e pretenduar nuk ishte i ngjashëm me nënshkrimin e paraqitësit të kërkesës në kontratën e vërtetuar në vitin 1995. Më tutje theksohet se dokumentet e paraqitura nga pala përgjegjëse në kërkesë nuk kanë mundur të verifikohen pasi ato nuk janë regjistruar në kompanitë publike përkatëse të cilat supozohet edhe t'i kenë lëshuar.

7. Vendimi i KKPK-së i është dorëzuar palës përgjegjëse në kërkesë me 11 prill 2013. Ai paraqiti ankesë kundër tij me 24 prill 2013.

8. Ankesa i është dorëzuar paraqitësit të kërkesës D. K. me 23 korrik 2013. Ai paraqiti përgjigjen e tij, me 21 gusht 2013.

Arsyetim ligjor:

Pranueshmëria e ankesës:

9. Ankesa është pranueshme. Ajo është paraqitur brenda afati prej 30 ditës të përcaktuar me nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079.

Juridiksioni:

10. Kolegji i Apelit të AKP-së të Gjykatës Supreme të Kosovës njofton se KKPK-ja ka juridiksion ndaj kërkesës pasi ajo bie në kategorinë e kërkesave siç përcaktohet me nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079. Humbja e posedimit ka ndodhur për shkak të rrethanave që drejtpërsëdrejti ndërlidhen apo rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999. Kolegji i Apelit të AKP-së ka kompetencë ndaj ankesave të paraqitura kundër vendimit të KKPK-së.

Meritat e ankesës:

11. Gjykata Supreme konsideron se KKPK-ja është e saktë në përfundimin e vet për sa i përket meritave të kërkesës së paraqitësit të kërkesës dhe asaj të palës përgjegjëse në kërkesë.

12. Më parë, që të dy kërkesat kundërshtuese që janë paraqitur në KKPB nga paraqitësi i kërkesës dhe pala përgjegjëse në kërkesë, janë refuzuar. Çështja nuk është zgjedhur me vendim përfundimtar. Megjithatë, gjatë procedurave në fjalë kontrata për shitblerje VR.Nr. 223/95 e datës 7 dhjetor 1995 nuk është ekzaminuar nga KKPB-ja pasi ajo nuk është paraqitur si provë nga paraqitësi i kërkesës. Paraqitësi i kërkesës e shpjegon se në ato kohë ende nuk e kishte në posedim. Vendimi për ndarjen e banesës dhe kontrata për shitblerje të paraqitura nga paraqitësi i kërkesës në procedurën aktuale janë verifikuar pozitivisht nga AKP-ja. Kontrata për shitblerje është vërtetuar në mënyrë të rregullt nga Gjykata Komunale në Prishtinë. Kështu që, paraqitësi i kërkesës e ka vërtetuar titullin e tij të pronës ndaj banesës së përmendur.

13. Sidoqoftë, kontrata për shitblerje dhe faturat e tjera të paraqitura nga pala përgjegjëse në kërkesë janë verifikuar negativisht nga AKP-ja. Asnjëra nga to nuk mund të gjendët në arkivat e institucioneve që supozohet t'i kenë lëshuar ato. Për më tepër, raporti i forenzikës ka vërtetuar se nënshkrimi në kontratën për shitblerje të paraqitur nga pala përgjegjëse në kërkesë nuk është vënë nga paraqitësi i kërkesës Daragan Kosanin. Kështu që, pala përgjegjëse në kërkesë nuk ka mundur ta vërtetojë pretendimin e vet se e kishte blerë pronën nga paraqitësi i kërkesës.

14. Prandaj, ankesa e palës ankuese refuzohet si e pabazuar sipas nenit 13.3 (c) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079.

Këshillë juridike

15. Në përputhje me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme juridike.

ElkaFilcheva-Ermenkova, Kryetare e Kolegjit, EULEX

SylejmanNuredini, Gjyqtar

EsmaErterzi, Gjyqtare e EULEX-it

Urs Nufer, Referent i EULEX-it